



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.989/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Dren Rogova, në çështjen juridike përmbare të kreditorit “Rilindja A.G.E.” SH.P.K., nr. unik identifikues ..., me seli në Prishtinë, kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministra e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, rr.“Ukshin Hoti” nr.120, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbare për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.434/2022 të datës 28.04.2023, me datë 17.11.2023, mori këtë:

### A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministra e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, rr.“Ukshin Hoti” nr.120, me seli në Prishtinë, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.434/2022 i datës 28.04.2023 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.434/2022 të datës 28.04.2023, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Qeveria – Ministra e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të paraqitur kundër urdhrit përmbare P.nr.123/2020 të datës 17.07.2020, të përmbaresit privat Destan Bujupaj. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi urdhrin përmbare P.nr.123/2020 të datës 17.07.2020, të lejuar nga përmbaresi privat Destan Bujupaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur debitori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa të miratohet në tërësi si e bazuar të ndryshohet aktvendimi i ankimuar apo i njëjti të priset dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit

për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Rilindja A.G.E.” SH.P.K., nr. unik identifikues 810851297, me seli në Prishtinë, me datë 17.07.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministra e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, rr.“Ukshin Hoti” nr.120, me seli në Prishtinë, në bazë të dokumenti të besueshëm, faturave faturave me numër 523, 1594, 1599, 1595, 3192, 3191, 2887, 2885, 2886, 1329, 1328, 1327, 1329, 1868, 1869, 1870, 2114, 2113, 2112, 2360, 2359, 2358, 2639, 2640, 2641, 162, 163, 407, 408, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 1,919.10 €.

Përmbartuesi privat Destan Bujupaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.123/2020 të datës 17.07.2020, ka lejuar përmbartimin, duke vlerësuar se faturat e lëshuar nga kreditori i plotësojnë kushtet për përmbartim. Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori me datë 04.08.2020 ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se për kohën e kompensimit të faturave kontestuese nuk ka pasur Kontratë për Furnizim me gazeta ditori për nevojat e MBPZHR-së, debitori dhe kreditori kanë pasur Kontratë për Furnizim me gazeta ditori për nevojat e MBPZHR-së, me Ref .14/01-06/17 e datës 20.04.2017 me afat kohor prej një viti, prej datës 20.04.2017 deri me datë 19.04.2018. Tutje debitori ka deklaruar se faturat e dërguara nga kreditori janë pabazë sepse për periudhën që janë lëshuar faturat nuk kanë pasur kontratë me shkrim për furnizim me gazeta ditore për nevoja të MBPZHR-së, dhe se faturat e tilla nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga menaxheri i kontratës, pra janë jashtë afatit ligjor të precizuar nga data 20.04.2017 deri me datë 19.04.2018. Debitori nuk mbanë përgjegjësi për shërbimet e pa porositura dhe pa bazë ligjorë pasi që nuk kanë kontratë të lidhur për këtë shërbim, duke e mohuar borxhin me arsyetimin se shërbimet nuk janë porosit nga debitori dhe si të tillë nuk mund ta kompenson, andaj ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri për përmbartim P.nr.123/2020 i datës 17.07.2020. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 07.08.2020, duke i kundërshtuar të gjitha pretendimet e debitorit në prapësim, me arsyetimin se në rastin konkret kreditori e ka furnizuar me gazeta debitorin në kohëzgjatje prej 15 vitesh, në bazë të kërkesës së tij dhe me rastin e dorëzimit gjithmonë i ka dorëzuar edhe faturën e rregullt, të cilën debitori e ka pranuar dhe protokolluar në mënyrë ligjore pa pasur asnjë vërejtje. Në bazë të këtyre faturave debitori ka paguar borxhin deri në muajin maj të viti 2019 edhe pse nuk kanë pasur kontratë, andaj kreditori ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimi dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.434/2022 të datës 28.04.2023, ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.123/2020 të datës 17.07.2020, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomik, ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për arsyes se në rastin konkret fatura në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Tutje gjykata ka arsyetuar se ka vlerësuar pretendimet e debitorit se urdhri për përmbartim nuk është i rregullt dhe nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në LPP-ë, sipas të cilit propozimi për përmbartim duhet të ketë edhe nënshkrimin e faturës së pranuar, se nuk ka prova se fatura është dorëzuar tek debitori Menaxheri i kontratës, mirëpo të njëjta i vlerësoi si të pabazuar, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar përmbartimi mbajë vulat e debitorit me numër dhe datë të saktë tek secila faturë, dhe nga vet fakti se personat të cilët e kanë vulosur faturën i është dhënë vula në posedim vërtetohet se të njëjtit kanë qenë të autorizuar për pranimin e faturave.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, nuk e përkrah Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, për arsye se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës, si dhe ankesën e palës ankuese ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale për të cilën gjykata çdoherë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së e cila shkelje sipas vlerësimit të kësaj gjykate ka ardhur si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu kjo gjykatë ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 të LPK-së si dhe lidhur me nenin 17, 29 paragrafi 1, pika 1.1 dhe nenin 38 të LPP-ës, për çka u deshtë që ky aktvendim të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se kjo e fundit gabimisht ka konstatuar se faturat me numër 523, 1594, 1599, 1595, 3192, 3191, 2887, 2885, 2886, 1329, 1328, 1327, 1329, 1868, 1869, 1870, 2114, 2113, 2112, 2360, 2359, 2358, 2639, 2640, 2641, 162, 163, 407, 408, përbejnë dokumente të besueshme, të përshtatshme për përmbartim dhe se në rastin konkret paraqesin bazë për lejimin e përmbartimit në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 29 të LPP-së, për arsye se pas analizimit dhe vlerësimit të faturave nga ana e kësaj gjykate, nuk mund të vërtetohet se të njëjtat janë të pranuar në mënyre të rregullt nga ana e debitorit ngase nga shkresat e lëndës konstatohet qartë se mungon pranimi i rregullt, nënshkrimi i debitorit dhe se vula e pranimit të dokumentit nga debitori nuk e bënë me automatizëm kreditorin subjekt me të drejtë të arkëtimit të asaj shume në procedurë përmbartimore. Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se fakti se debitori si institucion publik pranon dokumente, përfshirë në rastin konkret faturat kontestuese, si dokumente me vulë të pranimit (të protokolluar), nuk nënkupton se i ka pranuar faturat si të tilla

dhe shërbimin e ofruar të cilin e përmbajnë të njëjtat, respektivisht prestimin sipas faturave. Që fatura të konsiderohet si pranimit i rregullt, do të duhej që debitori si palë kontraktuese, apo përfitues i shërbimeve ta pranonte faturën e rregullt me vënien e nënshkrimit nga personi përgjegjës apo i autorizuar.

Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret faturat e pa nënshkruara nga debitori nuk mund të konsiderohen dokumente të besueshëm mbi bazën e te cilave mund të lejohet përmbarimi dhe të përshatshme për përmbarim. Andaj, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejtë provat nga shkresat e lëndës sepse në këtë rast kjo gjykatë vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për lejimin e përmbarimit.

Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë duke i pranuar si të themelta pretendimet ankimore të palës debitore në këtë drejtim, çështjen vendosi t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vlerësojë edhe njëherë pretendimet e palës debitore lidhur me prapësimin e tij, respektivisht të vlerësojë se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbarimit nga ana e përmbaruesit privat e më pastaj ka mundësi që të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në veçanti gjykata e shkallës së parë ka për detyrë të përcaktojë nëse faturat rrjedhin nga kontrata e bashkangjitur në shkresat e lëndës, respektivisht shërbimet a i takojnë periudhës kontraktuese. Andaj, në mënyrën se si janë lëshuar, gjykata duhet të vlerësojë se faturat a i plotësojnë kushtet e përmbarueshmërisë sipas LPP-së dhe të arsyetohet nëse me ndonjë veprim debitori i ka pranuar faturat dhe rrjedhimisht objektin e detyrimit të përshkruar në faturë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.989/2023, me datë 17.11.2023.

Gjyqtari,  
Dren Rogova